



HALLAKAMË NË KUVEND, VETËVENDOSJA REFUZON TA THËRRASË SEANCËN KONSTITUIVE

FAQE 4-5




Tensionet në Kuvendin e Kosovës kanë eskaluar të mërkurën. Deputetë të PDK-së, të AAK-së dhe të Vetëvendosjes janë përplasur verbalisht dhe fizikisht për shkak të mosvazhdimt të seancës konstituive. Deputetët e PDK-së dhe të Aleancës kanë kërkuar

vazhdimisht nga kryesuesi Avni Dehari që ta thërrasë seancën dhe të vazhdojë procesi i konstituimit të Kuvendit. Ata e kanë akuzuar Vetëvendosjen për bllokim të institucioneve dhe për shkelje të rendit kushtetues. Në anën tjetër, Vetëvendosja ka insistuar se

vazhdimi i procesit duhet të paraprihet nga një marrëveshje politike. Në krejt këtë hallakamë, LDK-ja ka qëndruar indiferente, pasi asnjë deputet i saj nuk ka qenë në sallën e Kuvendit. Krahas deputetëve, edhe qytetarët janë përplasur gjatë vizitës në Kuvend

**14 ORGANIZATA
I DREJTOHEN
KUSHTETUESËS
PËR AFATIN
E KONSTITUIMIT
TË KUVENDIT** F. 4-5



**SENATORJA ERNST NË
KOSOVË, AMBASADA
AMERIKANE:
U THEKSUA RËNDËSIA
E 'MARRËDHËNIEVE
KONSTRUKTIVE
SHBA - KOSOVË'** F. 3



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +389 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVË
STYROLKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



**IDEJA E VUÇIQIT PËR IBRIN:
KËRCËNIM POLITIK APO SKENAR
REAL ME PASOJA PËR KOSOVËN?** F. 7

**KURTI: TË RINJTË DHE TË REJAT
DUHET TË JENË NË QENDËR TË
POLITIKAVE DHE VENDIMMARRJES** F. 8

**AKTAKUZË PËR KRIME LUFTE NË
REZNIK, DYSHOHET SE U VRANË
NËNTË CIVILË SHOQIPTARË** F. 3

EKONOMI



**INFLACIONI NË KOSOVË
ARRIN 6.5 PËR QIND** F. 8

**RAFUNA: EKSPORTET JANË
RRITUR MBI NJË MILIARD,
INSTITUCIONET TË KENË KUJDES
SI PO I TRAJTOJNË PRODUKTET
VENDORE** F. 8

SPORT



**FILLON PUNËN AKADEMIA E
PORTIERËVE PËR GJENERATAT
2011 DHE 2012** F. 11

Trumpi: ShBA-ja ka 'kontrollin absolut' mbi Ngushticën e Hormuzit

WASHINGTON, 12 GUSHT - Presidenti amerikan Donald Trump ka deklaruar se Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) kanë "kontroll të plotë" mbi Ngushticën e Hormuzit, ndërsa tensionet me Iranin vazhdojnë. "Ne kemi kontroll të plotë mbi Ngushticën e Hormuzit tani. Ata nuk e kanë

kontrollin. Ne e kemi kontrollin. Ne e zotërojmë atë", ka deklaruar Trumpi para gazetarëve. Ai ka thënë se nuk i beson Iranit dhe ka paralajmëruar një reagim të ashpër nëse Teherani përpiqet ta sfidojë ShBA-në. "Unë nuk i besoj Iranit. Ata më kanë gënjyer vazhdimisht", ka

thënë Trumpi, duke shtuar se nëse Irani ndërmerr ndonjë veprim kundër ShBA-së, "do të shkatërrohet". Ngushtica e Hormuzit mbetet një nga pikat kryesore të tensionit në përplasjen ShBA - Iran, ndërsa çështja e rihapjes së saj për lundrim vazhdon të jetë pjesë e negociatave.



ZELENSKY: IA KEMI DORËZUAR SHBA-së PROPOZIMET PËR T'I DHËNË FUND LUFTËS

KIEV, 12 GUSHT - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, ka deklaruar se ua ka dorëzuar Shteteve të Bashkuara propozimet për t'i dhënë fund luftës me Rusinë.

"Ne ia kaluam propozimet tona palës amerikane", ka thënë Zelensky. Sipas tij, ShBA-ja mund të ndihmojë në forcimin e mbrojtjes së Ukrainës, veçanërisht përmes sistemeve të mbrojtjes ajrore, si dhe të ushtrisë presion ndaj Moskës

për ta orientuar atë drejt përfundimit të luftës.

Deklaratat e Zelenskyt vijnë në një periudhë kur përpjekjet për paqe të ndërmjetësuar nga ShBA-ja kanë mbetur në vendnumëro.

Me ndërmjetësimin amerikan, Rusia dhe Ukraina zhvilluan tre raunde bisedimesh në janar dhe shkurt, por negociatat janë ndërprerë që atëherë.

Sipas Kievit dhe Moskës, ndërprerja e bisedimeve lidhet

me përqendrimin e ShBA-së në konfliktin e armatosur në Lindjen e Mesme i cili nisi më 28 shkurt.

Zelensky ka ngritur gjithashtu shqetësimin për një mobilizim të ri të mundshëm në Rusi. Duke iu referuar një raporti të inteligjencës ukrainase, ai ka thënë se presidenti rus, Vladimir Putin, mund të urdhërojë rekrutimin e disa qindra mijëra trupave të rinj pas zgjedhjeve të shtatorit.



UNESCO: 2.4 MILIONË VAJZA AFGANE JANË PËRJASHTUAR NGA ARSIMI I MESËM



KABUL, 12 GUSHT - Sipas një vlerësimi të publikuar nga UNESCO, rreth 2.4 milionë vajza në Afganistan janë aktualisht të privuara nga arsimi i mesëm për shkak të politikave të qeverisë talebane. UNESCO ka paralajmëruar se kjo shifër mund të rritet në gati 4 milionë deri në vitin 2030. Afganistani është aktualisht i vetmi vend në botë ku vajzave dhe grave u ndalohej arsimimi përtej nivelit fillor. Pas marrjes së pushtetit në vitin 2021, talebanët vendosën kufizime të forta ndaj të drejtave të grave, duke i përjashtuar nga shkollat e mesme dhe universitetet, si dhe duke kufizuar ndjeshëm pjesëmarrjen e tyre në tregun e punës.

UNESCO e ka konsideruar këtë politikë shkelje serioze të të drejtave të njeriut dhe paralajmëron se pasojat do të jenë

të mëdha edhe për ekonominë afgane.

Sipas organizatës, në një vend ku pothuajse gjysma e popullsisë jeton nën kufirin e varfërisë, mohimi i arsimit dhe punësimit për gratë dobëson aftësinë e familjeve për të siguruar të ardhura dhe pengon zhvillimin ekonomik.

Ndërsa ekspertët kanë paralajmëruar gjithashtu se vajzat që nuk mund të vazhdojnë shkollimin përballen me rrezik më të madh për martesë në moshë të re dhe pasoja negative për mirëqenien e tyre.

UNESCO ka vlerësuar se Afganistani mund të humbasë rreth 9.6 miliardë dollarë të ardhura deri në vitin 2066, pasi shumë gra të arsimuara mund të mos kenë mundësi të marrin pjesë në fuqinë punëtore.

BE-ja ndan 2 milionë euro për komunitetet e prekura nga tërmeti në Kolumbi

BRUKSEL, 12 GUSHT - Bashkimi Evropian ka mobilizuar 2 milionë euro ndihmë për komunitetet e prekura nga tërmeti që goditi Kolumbinë, ndërsa ekipet e emergjencës vijojnë operacionet e kërkim-shpëtimit. Lajmi është bërë me dije nga presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, e cila ka konfirmuar se fondet do të orientohen drejt zonave më të

prekura. "Ndërsa operacionet e kërkim-shpëtimit vazhdojnë, BE-ja po e mbështet Kolumbinë sa herë që është e mundur. Ne po vëmë në dispozicion dy milionë euro për t'i mbështetur komunitetet në zonat më të prekura", ka deklaruar von der Leyen në një postim në platformën "X".

Mbështetja evropiane vjen pasi autoritetet kolumbiane kanë aktivizuar Mekanizmin e

Mbrojtjes Civile të BE-së, një instrument që mundëson koordinimin e ndihmës së ofruar nga vendet evropiane në situata emergjente. Sipas informacionit të bërë publik, ndihma do të përshtatet në varësi të situatës në terren dhe nevojave të paraqitura nga autoritetet kolumbiane. Ndërkohë, operacionet e kërkim-shpëtimit vijojnë në zonat e prekura nga tërmeti.



Senatorja Ernst në Kosovë, Ambasada Amerikane: U theksua rëndësia e "marrëdhënieve konstruktive ShBA - Kosovë"

PRISHTINË, 12 GUSHT - Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Prishtinë ka bërë me dije se vizita e senatores amerikane Joni Ernst në Kosovë i ka shërbyer asaj për të kuptuar më nga afër zhvillimet aktuale në vend. "Senatorja Joni Ernst përmbylli vizitën e saj në Kosovë pas takimeve me drejtuesit e institucioneve të Kosovës,

përshëndetjes së trupave nga Iowa në Kampin Film City, si dhe vizitës në Kampin Bondsteel dhe takimit me pjesëtarët e përkushtuar të Komandës Rajonale Lindje të KFOR-it dhe Grupit të Mbështetjes së Zonës-Balkan", është thënë në njoftimin e Ambasadës Amerikane.

Në njoftim është përmendur

edhe nderimi i senatores me Medaljen Presidenciale të Meritave. "Takimet produktive të senatores i ofruan asaj një pasqyrë të vlefshme dhe të drejtpërdrejtë mbi zhvillimet aktuale në Kosovë, si dhe theksuan rëndësinë e një marrëdhënieje konstruktive mes të ShBA-së dhe Kosovës", është thënë në njoftim.



KEARNS: EVROPA T'I 'LUFTOJË' LIDHJET SERBI - RUSI - KINË, BRITANIA QËNDRON PËRKRAH KOSOVËS

PRISHTINË, 12 GUSHT - Deputetja britanike Alicia Kearns nuk ka ngurrar t'i komentojë zhvillimet e fundit rreth Kosovës pas deklaratave të presidentit serb Aleksandar Vuçiq për mundësinë e devijimit të rrjedhës së lumit Ibër. Në një postim në "X", ajo i është referuar shkurt e qartë reagimit të kryeministrit shqiptar, Edi Rama, ndaj këtij plani të Serbisë, duke shkruar: "Kjo është diplomaci".

Në cilësinë e mbështetëses së Kosovës dhe këmbëngulëses që bashkësia ndërkombëtare të jetë më e rreptë ndaj Serbisë, e cila, sipas saj, nuk resht së punuari për shfuqizimin e shtetit më të ri në Evropë, Kearns ka dhënë një intervistë për "Kosovapress".

Deputetja Kearns, e cila ishte ndër politikanet e para ndërkombëtare që kishte ngritur zërin për armatosjen e serbëve në veri, shumë kohë para sulmit në Banjskë, ka folur për afrimin e Serbisë me Rusinë dhe Kinën, për rrezikun nga krijimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, por edhe për raportin aktual të Kosovës me strukturat euroatlantike dhe vendet aleate. "Shpresoj sinqerisht se Serbia një ditë do ta njohë Kosovën. Fatkeqësisht, nuk kam parë asnjë dëshmi se qeveria aktuale do ta bëjë këtë. Komentet e fundit të ministrit serb Paunović, që promovojnë dhe glorifikojnë spastrimin etnik, dëshmojnë për një mendësi që vazhdon të ekzistojë



te disa politikanë serbë. Do ta paralajmëroja çdo vend evropian kundër marrëdhënieve më të afërta me Partinë Komuniste të Kinës. Në fakt,

rregullisht i bëj thirrje qeverisë sime të ndërmarrë veprime për t'iu kundërvënë veprimeve armiqësore nga Kina, përfshirë represionin transnacional,

vjedhjen e pronësisë intelektuale, subvencionet shtetërore që shtrembërojnë tregun dhe madje spiunazhin në Parlamentin britanik. Çdo

mbështetje apo bashkëpunim me Rusinë pas pushtimit të paligjshëm dhe brutal të Ukrainës duhet të dënohet pa asnjë hezitim", ka thënë Kearns.

Aktakuzë për krime lufte në Reznik, dyshohet se u vranë nëntë civilë shqiptarë

PRISHTINË, 12 GUSHT - Prokuroria Speciale e Kosovës ka ngritur aktakuzë ndaj S. S. për veprën penale "Krime lufte kundër popullsisë civile", lidhur me ngjarjet e 6 prillit 1999 në fshatin Reznik të Vushtrrisë. Sipas aktakuzës, S. S., në bashkëpunim me pjesëtarë të tjerë të forcave serbe dhe me S. T., i cili tashmë është dënuar nga

Gjykata Themelore në Prishtinë, dyshohet se ka marrë pjesë në vrasjen e nëntë civilëve shqiptarë. Prokuroria pretendon se disa nga viktimat janë djegur për së gjalli, ndërsa të tjerat janë djegur pasi paraprakisht ishin vvarë. Në aktakuzë është thënë gjithashtu se S. S., së bashku me persona të armatosur, dyshohet



se ka hyrë në shtëpitë e familjeve shqiptare të cilat më pas janë plaçkitur dhe u është vënë zjarri. Pas përfundimit të hetimeve, rasti i është dorëzuar për shqyrtim Gjykatës Themelore në Prishtinë. Sipas Prokurorisë Speciale, i pandehuri S. S. aktualisht ndodhet në paraburgim.

HALLAKAMË NË KUVEND, VETËVENDOSJA REFUZON TA THËRRASË SEANCËN KONSTITUIVE

Tensionet në Kuvendin e Kosovës kanë eskaluar të mërkurën. Deputetë të PDK-së, të AAK-së dhe të Vetëvendosjes janë përplasur verbalisht dhe fizikisht për shkak të mosvazhdimi të seancës konstituive. Deputetët e PDK-së dhe të Aleancës kanë kërkuar vazhdimisht nga kryesuesi Avni Dehari që ta thërrasë seancën dhe të vazhdojë procesi i konstituimit të Kuvendit. Ata e kanë akuzuar Vetëvendosjen për bllokim të institucioneve dhe shkelje të rendit kushtetues. Në anën tjetër, Vetëvendosja ka insistuar se vazhdimi i procesit duhet të paraprihet nga një marrëveshje politike. Në krejt këtë hallakamë, LDK-ja ka qëndruar indiferente, pasi asnjë deputet i saj nuk ka qenë në sallën e Kuvendit. Krahas deputetëve, edhe qytetarët janë përplasur gjatë vizitës në Kuvend

EPOKA E RE**Lirim GECI**

PRISHINË, 12 GUSHT - Kosova ka dalë nga afatet kushtetuese për konstituimin e Kuvendit. Procesi ka tejkaluar afatin 30-ditor pas certifikimit të rezultateve, ndërsa nuk është respektuar as Rregullorja e Kuvendit për thirrjen e seancës brenda 48 orësh. Kryesuesi i seancës konstituive, Avni Dehari, nuk e ka thirrur vazhdimin e seancës, duke e lidhur vijimin e procesit me arritjen e një marrëveshjeje politike. Kjo situatë ka bërë që të mërkurën të ketë përplasje në Kuvendin e Kosovës mes deputetëve të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe Aleancës, në njërën anë, dhe përfaqësuesve të Lëvizjes Vetëvendosje, në anën tjetër, të cilat kanë eskaluar edhe në përplasje fizike. Deputeti i PDK-së, Mërgim Lushtaku, e ka shtyrë me duar deputetin e LV-së, Adnan Rustemin, ndërsa deputeti tjetër i LV-së, Ardian Gola, ka ndërhyrë në mes. Ndërsa deputetja e Aleancës, Albana Bytyqi, e ka shtyrë deputeten e LV-së, Arbërie Nagavci, e cila, së bashku me deputeten e PDK-së, Ganimete Musliu, është goditur edhe me letra. Përplasjet kanë zgjatur rreth dy orë, kryesisht në formë verbale, për shkak të mosmarrëveshjeve lidhur me procedurat e konstituimit të Kuvendit. Ministria në detyrë e Drejtësisë, Donika Gërvalla, e cila kishte hyrë në sallë për aktivitetin "Bashkatdhetarët në Kuvend", u ka bërë thirrje deputetëve të PDK-së dhe Aleancës që të marrin pjesë në takimet e ftuara nga LV-ja për arritjen e një marrëveshjeje politike. "Ejani në takim", u ka

thënë Gërvalla deputetëve të cilët brohorisin "Thirrni seancën!". Krahas kërkesës për thirrjen e seancës, deputetët e PDK-së i kanë quajtur "superkriminelë" përfaqësuesit e Vetëvendosjes, duke i akuzuar për shkelje të Kushtetutës. Në përplasje të tjera janë përfshirë edhe ushtruesja e detyrës së presidentes, Albulena Haxhiu, si dhe deputetët e PDK-së, Vlora Çitaku, Përparim Gruda, Eman Rrahmani, Blerta Deliu-Kodra dhe Sala Jashari. Po ashtu, në debat janë përfshirë edhe deputetët e AAK-së, Besnik Tahiri, Albana Bytyqi dhe Bekë Berisha. Deliu-Kodra ka thënë se ata do të vazhdojnë të vijnë në Kuvend çdo ditë "për ta kthyer rendin kushtetues". Krahas deputetëve në sallën e Kuvendit janë përplasur edhe qytetarët të cilët kishin shkuar për të vizituar këtë institucion në kuadër të aktivitetit "Bashkatdhetarët në Kuvend". Përplasjet kanë ndodhur derisa deputetët e PDK-së dhe të Aleancës kanë kërkuar vazhdimin e seancës konstituive, pasi ka përfunduar afati 30-ditor për konstituimin e Kuvendit. Seanca konstituive nisi më 6 gusht, por Kuvendi nuk ka arritur ta përfundojë zgjedhjen e kryetarit dhe nënkryetarëve. Procesi ka mbetur pezull për shkak të mungesës së një marrëveshjeje politike. Megjithatë, Gërvalla ka thënë se interpretimi i LV-së është se seanca duhet të përmbyllet 30 ditë nga nisja e saj. PDK-ja dhe Aleanca kanë kërkuar nga kryesuesi i seancës konstituive, Avni Dehari, ta thërrasë vazhdimin e saj, ndërsa Lëvizja Vetëvendosje ka insistuar se fillimisht duhet të arrihet një marrëveshje politike.



**PDK-ja dhe Aleanca:
Bllokimi i Kuvendit është
cenim i sovranitetit, s'do
të lejojmë të dhunohet e
drejta e qytetarëve**

Para përplasjes në sallën e Kuvendit, deputeti i PDK-së, Arian Tahiri, ka thënë se Kuvendi po bllokohet dhe se, sipas tij, po cenohet rendi kushtetues i vendit. "Është një ditë që publiku dhe qytetarët janë duke parë që dyert e Kuvendit po mbyllen dhe Kuvendi po bllokohet. E patë edhe ju qasjen dhe mundësinë për të qenë këtu për t'i informuar qytetarët. Me cenimin e Kushtetutës, me tendencën e organizatën banditeske dhe përmes pushtetit po cenohet rendi kushtetues", ka thënë Tahiri. Ai ka deklaruar se PDK-ja, së bashku me Aleancën, po

angazhohet për mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe funksionalizimin e Kuvendit. "Ne jemi bashkërisht me Aleancën për ta bërë punën tonë, me qëllimin që ta mbrojmë kushtetutshmërinë dhe ta funksionalizojmë Kuvendin. Dje i jemi drejtuar me shkresë zyrtare kryesuesit, në mënyrë që të vazhdojë seanca dhe të funksionalizohet Kuvendi. Përkundër kërkesës sonë, nuk ka gjetur mbështetje dhe nuk është thirrur vazhdimi i seancës", ka deklaruar ai. Tahiri ka paralajmëruar se nëse shterohej të gjitha mundësitë, do të ndërmerren hapa të tjerë për mbrojtjen e shtetit. "Është më shumë se shqetësuese dhe sigurisht që do ta vazhdojmë qëndrimin tonë. Sigurisht që, nëse shteren mundësitë, do të jenë hapat tanë të tjerë për ta mbrojtur shtetin. E kemi amanet

ta ruajmë dhe mbrojmë", ka thënë Tahiri. Ai e ka kritikuar Albin Kurtin, duke deklaruar se vendi për 18 muaj nuk ka pasur stabilitet dhe normalitet institucional. "Që 18 muaj, prej kur Albin Kurti ka fuqinë më të madhe politike në këtë vend, nuk ka stabilitet e normalitet. Rrënohet tërësisht rendi kushtetues në vendin tonë. As nuk kemi qeveri, president, Kuvend. Shtrohet pyetja se çka është duke funksionuar", ka thënë ai. Në fund, Tahiri u ka bërë thirrje qytetarëve të ngrënë zërin dhe të alarmojnë për, siç ka deklaruar ai, veprimet që po e dëmtojnë shtetin e Kosovës. "Po ju kërkojmë që të ngrini zërin dhe të alarmoni kundër këtij njeriu, i cili është duke tentuar me veprime të tjera ta zhbëjë shtetin e Kosovës", ka përfunduar Tahiri. Ndërsa deputeti i Aleancës,



KUSARI-LILA: S'KA ALTERNATIVË TJETËR POS DIALOGUT POLITIK

PRISHTINË, 11 GUSHT - Ministria në detyrë e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, njëherësh kryetare e Alternativës, Mimoza Kusari-Lila, ka deklaruar se moskonstituimi i Kuvendit të Kosovës po shkakton shqetësim te qytetarët, mërgimtarët dhe komuniteti i biznesit.

Kusari-Lila ka thënë se situata aktuale paraqet shqetësim të madh edhe për sigurinë e investimeve në Kosovë. “Moskonstituimi i Kuvendit është brengë për mërgimtarët, është brengë për qytetarët e Republikës, është brengë shumë e madhe për bizneset për sigurinë e investimeve në Kosovë”, ka deklaruar ajo. Sipas saj, në situatën aktuale nuk ka alternativë tjetër përveç dialogut politik dhe arritjes së një marrëveshjeje ndërmjet subjekteve politike.

Ajo u ka bërë thirrje drejtuesve politikë dhe partiakë që të ulen në tryezën e dialogut dhe të merren vesh për një plan konkret institucional. “Megjithatë, nuk ka alternativë tjetër pos dialogut politik, arritjes së marrëveshjes politike dhe pranimit të drejtuesve politikë e partiakë të Republikës së Kosovës se veç të ulen, të dakordohen dhe të kemi një orar e afat edhe të konstituimit të Kuvendit, të votimit të Qeverisë dhe të zgjedhjes së presidentit. Singlerisht, ju them të drejtën, është një keqardhje që komunikimi i drejtuesve politikë, në veçanti të opozitës së deritanishme, po bëhet përmes medieve e jo përmes pranimit të pjesëmarrjes në takim. Unë e kuptoj rëndësinë e deklaratave politike, e kuptoj rëndësinë e komunikimit me elektoratin e secilit se, fatmirësisht, jemi në



demokrati. Secili ka votuesit e përkrahësit e orientimeve të veta politike, por interesi i shtetit është një. Kosova ka nevojë për Kuvend të konstituuar, për qeveri të votuar, për president ose presidente që është në zyrë me mandat të plotë”, ka thënë Kusari-Lila, duke shtuar se kjo situatë nuk i shkon për shtati askujt, por gjithashtu edhe prej

kësaj situatë nuk mund të dilet e të ketë zgjidhje pa dialog politik. “Është me të vërtetë e pakuptimtë mosmarrëveshja ose mospranimi i ftesës për të qenë në takim me kryetarin e Lëvizjes Vetëvendosje, kryeministrin në detyrë, zotën Albin Kurti. Nuk ka arsyetim. Nuk mundet asnjë argument i cili, qoftë me vendimin mos me

qenë në qeveri ose me qenë në opozitë, apo me vendimin se nuk po ka besim të ndërsjellë. Gjysma e elektoratit të qytetarëve me të drejtë vote ia kanë dhënë besimin grupit të Lëvizjes Vetëvendosje bashkë me partnerët e vet. Prandaj, edhe si e tillë, nuk mundet askush të mendojë për një formim të institucioneve, konstituim të organeve drejtuese të shtetit, pa Lëvizjen Vetëvendosje. Prandaj, edhe mospranimi në diskutim të mëturshëm, qoftë i Partisë Demokratike apo i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, nuk ka arsytueshmëri”, ka thënë Kusari-Lila.

Ajo ka thënë se mospranimi i takimeve për konstituimin e institucioneve paraqet më shumë shkelje të besimit demokratik sesa çështje të formës së realizimit të tyre.

Besnik Tahiri, ka thënë se kanë shkuar në Kuvend me ftesën e grupit parlamentar të PDK-së për të ushtruar, siç ka deklaruar ai, një funksion jetik institucional. Ai ka deklaruar se bllokimi i Kuvendit përbën cenim të sovranitetit, rendit kushtetues dhe demokracisë. “Sovraniteti i takon popullit, u takon institucioneve të zgjedhura dhe ne këtu jemi të zgjedhurit. Bllokimi i Kuvendit të Kosovës është cenim i sovranitetit, rendit kushtetues dhe demokracisë. Ne nuk do të lejojmë në asnjë formë e në asnjë mënyrë që të dhunohet e drejta e qytetarëve me qenë në Kuvend dhe me pasë institucione”, ka thënë Tahiri.

Tahiri ka deklaruar se, sipas tij, janë shkelur tri norma kryesore që rregullojnë funksionimin e Kuvendit: Neni 66 i Kushtetutës, aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, përkatësisht neni 140, dhe Rregullorja e Punës që përcakton mbledhjen brenda 48 orësh. Ai ka thënë se çdo justifikim për mosfunksionalizimin e Kuvendit përbën, sipas tij, tentim për bllokimin e votës së lirë të qytetarëve. “Çfarëdo justifikimi është tentim për të bllokuar votën e lirë të qytetarëve që e përfaqësojmë ne”, ka deklaruar Tahiri.

Edhe deputeti i PDK-së, Përparim Gruda, ka thënë se Kosova është “marrë peng” nga Lëvizja Vetëvendosje dhe ka kërkuar vazhdimin e seancës konstituive të Kuvendit. Gruda ka deklaruar se mospërgjigjja e pushtetit ndaj kërkesës për vazhdimin e seancës konfirmon, sipas tij, instalimin e një regjimi autoritar. “Qytetarët e Kosovës duhet ta dinë që nëse sot Kushtetuta shkelet për një afat, për një procedurë, nesër ky pushtet autoritar do të trokasë në derën e çdo qytetari të Kosovës për t’ia shkelë të drejtat elementare, për t’ia shkatërruar biznesin, për ta nxjerrë prej punës, për ta degraduar në punë”, ka thënë ai.

Ai ka theksuar se “Kosova është marrë peng. Institucionet e

Kosovës janë marrë peng”. Gruda ka thënë se kjo është një fatkeqësi ndaj së cilës duhet të reagojë e gjithë shoqëria për të mbrojtur, siç është shprehur ai, atë që është ndërtuar.

“Asnjë regjim autoritar nuk është instaluar brenda natës. Ky është fillimi i instalimit të një regjimi autoritar”, ka deklaruar Gruda. Gjatë përplasjes me deputetët e LV-së, Gruda i ka akuzuar ata se kanë dërguar dosje në Hagë kundër liderëve të UÇK-së.

Haxhiu për “opozitën”: Njëherë thanë se është tejkaluar afati, tash kërkojnë thirrjen e seancës. Unë s’po i kuptoj

Ushtruesja e detyrës e presidentes së Kosovës, Albulena Haxhiu, ka folur për situatën e krijuar në Kuvend dhe kërkesat e opozitës për thirrjen e seancës. Ajo ka deklaruar se opozita ka ndryshuar qëndrimin, pasi fillimisht kishte thënë se afati ishte tejkaluar dhe se seanca nuk duhej të thirrej. “Njëherë thanë e keni tejkaluar afatin, mos thirrni seancë. Tash po thonë thirrni seancë. Unë s’po i kuptoj”, ka deklaruar Haxhiu. Ajo ka thënë se gjatë aktivitetëve të saj opozitare ka protestuar kundër marrëveshjeve që i ka konsideruar të dëmshme për vendin. “Unë jam një nga personat që kam bërë aktivitete opozitare, e dini shumë mirë, por gjithmonë kemi protestuar kundër marrëveshjeve të dëmshme për vendin: kundër Gjykatës Speciale, kundër ‘Zajednicë’, kundër amnistimit të kriminelëve serbë, kundër demarkacionit me Malin e Zi”, ka thënë ajo.

Haxhiu ka theksuar se nuk kanë protestuar kundër mërgatës apo rinisë. “Ne s’kemi protestuar kurrë kundër mërgatës asnjëherë, as kundër rinisë, por janë qytetarët ata që i vlerësojnë veprimet e secilit prej deputetëve”, ka deklaruar Haxhiu.



Hamza pas përplasjes në Kuvend: Kapje brutale e shtetit, Kuvendi s’është pronë e Kurtit dhe as e LV-së

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bedri Hamza, ka reaguar lidhur me bllokadën institucionale, duke deklaruar se Kuvendi nuk është pronë e Albin Kurtit dhe as e Lëvizjes Vetëvendosje. Hamza ka kërkuar që LV-ja ta thërrasë urgjentisht seancën për konstituimin e Kuvendit, ndërsa e ka akuzuar Kurtin se po e zvarrit procesin për shkak të kalkulimeve politike. “Kjo është kapje brutale e shtetit, shkelje e Kushtetutës dhe degradim i institucionit të të zgjedhurve të popullit. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese nuk janë rekomandime që zbatohen vetëm kur i konvenojnë pushtetit”, ka shkruar Hamza në “Facebook”.

Hamza ka deklaruar se konstituimi i Kuvendit është detyrim kushtetues dhe nuk mund të kushtëzohet me marrëveshje politike, kalkulime elektorale apo interesa personale. “Albin Kurti po e zvarrit procesin, sepse konstituimi i tashëm i Kuvendit ia prish kalkulimet politike. Sa më gjatë të mbahet vendi në këtë vakum institucional, aq më shumë hapësirë krijohet për skenarë të rinj politikë dhe zgjedhorë”, ka shkruar ai. Hamza ka theksuar se kjo, sipas tij, përbën “kapje brutale të shtetit, shkelje të Kushtetutës dhe degradim të institucionit të të zgjedhurve të popullit”. “Thirrjeni seancën. Respektoni Kushtetutën. Kuvendi duhet të konstituohet”, ka shkruar Hamza. Ai ka paralajmëruar se kushdo që mendon se mund ta mbajë Kosovën në “anarki kushtetuese dhe ligjore” për të realizuar kalkulime elektorale, sipas tij, “gabon rëndë”. “Kuvendi duhet të konstituohet tash, menjëherë!”, ka shkruar Hamza.

Gashi: Situata në Kuvend po shkon drejt përplasjeve fizike, po mungon pozicioni i qartë e i fortë i LDK-së

Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Arben Gashi, duke reaguar lidhur me tensionet në Kuvend, ka thënë se situata “po shkon drejt përplasjeve fizike”. Në një postim në “Facebook”, Gashi ka vlerësuar se, “në këtë moment kritik”, po mungon “një pozicionim i qartë dhe i fortë” i LDK-së. “Situata në Kuvend po shkon drejt përplasjeve fizike, ndërsa insistimi për bllokimin e tij vazhdon. Në këtë moment kritik, po mungon një pozicionim i qartë dhe i fortë i LDK-së. Në fakt, Kosovës po i mungon LDK-ja. Po i mungon fryma rugoviane. Sepse kur institucionet bllokohen dhe tensionet rriten, Kosovës i duhet më shumë dialog, maturi, shtet dhe Republikë. Është koha që LDK-ja të flasë”, ka shkruar Gashi.

SHEFI I KFOR-it: TRUPAT MUND TË SHTOHEN NËSE RREZIKOHET SIGURIA NË KOSOVË

PRISHTINË, 12 GUSHT - Gjeneralmajor Ozkan Ulutash, komandant i misionit të KFOR-it të udhëhequr nga NATO-ja, është takuar me kryetarin e Listës Serbe, Zlatan Elek, pas kundërshtimit të kësaj partie ndaj procesit të uljes graduale të pranisë së KFOR-it në urën kryesore mbi lumin Ibër në Mitrovicë. Takimi është zhvilluar me kërkesë të Elekut, në selinë e KFOR-it në Kampin "Film City", në Prishtinë. Në takim kanë marrë pjesë edhe nënkryetari i Listës Serbe, Igor Simiq, deputetja e kësaj partie në Kuvendin e Kosovës, Jovana Radosavljeviq, dhe kryetari i Mitrovicës së Veriut, Milan Radojeviq. Sipas KFOR-it, palët diskutuan për një sërë çështjesh, përfshirë situatën e sigurisë në veri të Kosovës dhe zbatimin e procesit të paralajmëruar për optimizimin e pozicionimit të

KFOR-it. Komandanti i KFOR-it u ka thënë përfaqësuesve të Listës Serbe se procesi i optimizimit është nisur si rezultat i përmirësimit të situatës së sigurisë në Kosovë. Ai ka theksuar se procesi do të zhvillohet gradualisht dhe do të jetë i bazuar në kushtet në terren, ndërsa trupat mund të rikthehen nëse zhvillimet e ardhshme ndikojnë në sigurinë e qëndrueshme në Kosovë dhe stabilitetin rajonal. KFOR-i ka bërë me dije se do të mbetet i pajisur dhe i pozicionuar për t'iu përgjigjur çdo zhvillimi relevant. "Tranzicioni gradual i pranisë së KFOR-it nga ura kryesore në Mitrovicë është në fazën fillestare", është thënë në njoftimin e KFOR-it. KFOR-i ka theksuar se, edhe pas përfundimit të procesit, do të mbajë një prani të fuqishme në Mitrovicën e Veriut dhe në pjesën

veriore të Kosovës. Lista Serbe kishte reaguar kundër njoftimit për uljen graduale të pranisë së KFOR-it në urën mbi Ibër, duke kërkuar që kjo masë të ndalej. Partia më e madhe e serbëve të Kosovës kishte kërkuar takim urgjent me komandantin e KFOR-it për t'ia përcjellë shqetësimet e komunitetit serb në veri. Lista Serbe kishte argumentuar se, për shkak të situatës politike dhe të sigurisë dhe tensioneve që në të kaluarën kanë shoqëruar zonën e urës, çdo ndryshim në pranimë e forcave të sigurisë duhet të bëhet me kujdes. Ajo kishte thënë se Policia e Kosovës nuk e gëzon besimin e serbëve në veri dhe se prania e KFOR-it në urë është një "faktor i rëndësishëm stabiliteti". Ura kryesore mbi lumin Ibër lidh Mitrovicën e Jugut, me shumicë shqiptare, me Mitrovicën e Veriut,



me shumicë serbe. Ajo është ruajtur nga trupat e KFOR-it që nga përfundimi i luftës në vitin 1999 dhe për vite me radhë ka qenë një prej pikave më të ndjeshme të sigurisë në veri të Kosovës. Aktualisht, ura është e hapur vetëm për këmbësorë. Misioni i NATO-s ka theksuar se vazhdon ta përmbushë mandatin e tij në bazë të Rezolutës 1244 të

Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, duke kontribuar në ruajtjen e një mjedisi të sigurt dhe lirisë së lëvizjes për të gjithë njerëzit në Kosovë. KFOR-i ka me dije se do të vazhdojë të veprojë në mënyrë të paanshme dhe në koordinim me Policinë e Kosovës dhe EULEX-in në përputhje me rolet e tyre përkatëse në fushën e sigurisë.

POLICIA E KOSOVËS HEDH POSHTË AKUZAT E LISTËS SERBE SE RRAHU NJË SERB

PRISHTINË, 12 GUSHT - Togeri i Policisë së Kosovës, Erduan Baliqi, i ka hedhur poshtë akuzat e Listës Serbe se pjesëtarë të Policisë së Kosovës kanë përdorur dhunë ndaj një qytetari serb në veri të vendit. Ai ka thënë se pretendimet tashmë po hetohen nga Inspektorati Policor i Kosovës (IPK). Pretendimet e një qytetari serb nga veriu i Kosovës, i identifikuar në disa raportime si Nenad Raskoviq, se është sulmuar dhe keqtrajtuar fizikisht nga pjesëtarë të Policisë së Kosovës, janë publikuar në medie në Beograd dhe në rrjetet sociale të eksponentëve politikë serbë. Për rastin ka reaguar edhe Lista Serbe, duke pretenduar se pjesëtarë të Policisë së Kosovës kanë përdorur dhunë ndaj qytetarit serb. Baliqi, në një prononcim për "Kosovapress", ka thënë se policia nuk ka informacion lidhur me pretendimet e personit në fjalë apo të Listës Serbe. "Ajo çfarë mund të themi në lidhje me pretendimet e personit apo personave në fjalë është se



policia nuk ka një informacion të tillë. Nuk kemi ndonjë informacion se është përdorur forca ndaj ndonjë personi. Megjithatë, mbrëmë rreth orës 21:00 kemi pranuar një informacion se një person ka kërkuar ndihmë mjekësore në Spitalin Rajonal të Mitrovicës. Njësit tona relevante kanë dalë në vendin e ngjarjes dhe, në momentin kur është publikuar në media pretendimi se është rrahur nga policia, ne menjëherë e kemi thirrur Inspektoratin Policor, i cili ka dalë në vendin e ngjarjes dhe po merret me rastin. Inspektorati

Policor i Kosovës do të zhvillojë hetime lidhur me pretendimet e palës", ka thënë Baliqi. Më tutje, ai ka konfirmuar se policia ka vepruar në pjesën veriore të vendit mbrëmë, duke thënë se policia në vazhdimësi pranon informacione se në lokacione të ndryshme mund të gjenden armë. "Ne kemi operuar në atë pjesë, mirëpo, sa u përket pretendimeve të tij se kanë qenë policët ata që e kanë rrahur, ne nuk kemi informacion se policia ka përdorur forcë ndaj ndonjë personi të mundshëm aty. Siç kemi thënë, policia pranon në

vazhdimësi informacione se në lokacione të ndryshme mund të gjendet armatim dhe ne nuk i neglizhojmë ato informacione. Jemi të obliguar t'i verifikojmë ato informacione", ka thënë Baliqi. Në ditët e fundit Policia e Kosovës ka zhvilluar aksione në rajonin e Zubin Potokut, gjatë të cilave, sipas të dhënave të bëra publike, janë gjetur dhe sekuestruar armë në lokacione të ndryshme. Sipas medieve serbe, Raskoviq ka pretenduar se policia i ka kërkuar një armë pa të drejtë, ndërkohë që kontrollët policore janë kryer mbi bazën e informacioneve për armë të mundshme të fshehura. Po ashtu, është pretenduar se informacione për posedim të armëve kanë ekzistuar edhe në rastin e Raskoviqit dhe se dyshohej për posedim të armëve të padeklaruara që nga periudha e luftës. Pretendime të tjera, të cilat nuk janë konfirmuar zyrtarisht, e lidhin këtë çështje edhe me dyshime për armë që mund të kenë lidhje me krimet e luftës të kryera në rajon. Këto

pretendime vijnë në kohën kur në zonën e Kalludrës në Zubin Potok janë zhvilluar gërmime në kuadër të kërkimeve për mbetje mortore të personave të vrarë gjatë luftës së viteve 1998-1999, ku dyshohet për ekzistencën e një varreze masive. Ditët e fundit Policia e Kosovës ka zhvilluar operacione në rajonin e Zubin Potokut, përfshirë kontrolle dhe veprime të lidhura me informacione për armë të mundshme të fshehura në zona të ndryshme. Në këtë kontekst, pretendimet për rastin e Raskoviqit janë lidhur në disa deklarime publike edhe me zhvillimet e fundit të sigurisë në veri dhe me operacionet policore në këtë pjesë të vendit. Megjithatë, deri më tani nuk ka një konstatim zyrtar që konfirmon ose rrëzon pretendimin se ndaj qytetarit është përdorur dhunë nga pjesëtarë të Policisë së Kosovës. Hetimet e Inspektoratit Policor pritet t'i sqarojnë rrethanat e rastit dhe nëse gjatë operacionit policor është përdorur forcë ndaj personit në fjalë.

Kurti: Të rinjtë dhe të rejat duhet të jenë në qendër të politikave dhe vendimmarrjes

PRISHTINË, 12 GUSHT - Të rinjtë dhe të rejat duhet të jenë në qendër të politikave dhe vendimmarrjes. Kështu ka deklaruar kryeministri në detyrë, Albin Kurti, në Ditën Ndërkombëtare të Rinisë, në aktivitetin "Zëri yt, e ardhmja jonë". Kurti ka theksuar se rreth 40 për qind e popullsisë së Kosovës përbëhet nga të rinj. Ai ka deklaruar se qeveria ka ndërmarrë një sërë masash në arsim, punësim, kulturë dhe sport, me synim krijimin e

mundësive më të mira për të rinjtë. Sipas Kurtit, përmes sistemit dual të arsimit është synuar lidhja më e madhe mes arsimit profesional dhe tregut të punës, ndërsa në arsimin e lartë janë ofruar bursa dhe mbështetje financiare për mijëra studentë. Ai ka përmendur edhe programin "Superpuna", përmes të cilit, sipas tij, janë punësuar më shumë se 23 mijë të rinj nga moshë 18 deri në 29 vjeç. Prej tyre, 51 për qind janë vajza dhe 49 për qind djem,

ndërsa rreth 10 500 biznese kanë përfutur nga programi. Kurti ka deklaruar se potenciali i të rinjve po reflektohet edhe në sektorin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, veçanërisht në eksportin e shërbimeve. "Rininë e shohim edhe si të tashmen, meqenëse është një pjesë e madhe e çmuar e shoqërisë sonë", ka thënë Kurti. Ai ka theksuar se mbështetja për të rinjtë duhet të vazhdojë edhe në kulturë dhe sport,



ndërsa u ka bërë thirrje të rinjve të komunikojnë me institucionet dhe të shprehin nevojat dhe kërkesat e tyre. "Ne nuk i premtojmë rinisë, ne

zotohemi dhe realizojmë tash dhe këtu për të", ka deklaruar Kurti, duke i uruar të rinjtë me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Rinisë.

IDEJA E VUÇIQIT PËR IBRIN: KËRCËNIM POLITIK APO SKENAR REAL ME PASOJA PËR KOSOVËN?

PRISHTINË, 12 GUSHT - Paralamjërimi i Bashkimit Evropian (BE), reagimet e ashpra në Kosovë dhe përplasja mes zyrtarëve në Tiranë e Beograd kanë pasuar deklaratën e presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, për mundësinë e ndryshimit të rrjedhës së lumit Ibër. BE-ja ka paralamjëruar se deklaratat e zyrtarëve serbë nuk kontribujnë në normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, proces që është kusht për përparimin e të dyja vendeve drejt anëtarësimit në BE.

“Deklaratat, përfshirë ato për ndryshime të mundshme të rrjedhës së lumenjve, si dhe veprimet që nuk janë në përputhje me këtë synim, duhet të shmangen”, është thënë në përgjigjen e BE-së për “Radion Evropa e Lirë”.

Edhe Departamenti Amerikan i Shtetit ka reaguar lidhur me këtë çështje, duke thënë për “Radion Evropa e Lirë” se paqja dhe stabiliteti në Ballkanin Perëndimor janë prioritet të Shteteve të Bashkuara. “Normalizimi i marrëdhënieve ndërmjet Serbisë dhe Kosovës është pjesë e domosdoshme e këtij procesi”, ka thënë një zëdhënës i Departamentit të Shtetit.

Ndryshimi i rrjedhës së Ibrit në mënyrë që lumi ta anashkalonte Kosovën do të ndërpriste prurjet e ujit në Liqenin e Ujmanit, një burim i rëndësishëm për furnizimin me ujë të Kosovës. “Nuk bëhet fjalë për një skenar në të cilin furnizimi me ujë do të ndërpritej menjëherë”, ka thënë për “Radion Evropa e Lirë” profesori i hidraulikës dhe burimeve ujore në Kosovë, Alban Kuriqi.

Për Dushan Janjiqin nga organizata joqeveritare Forumi për Marrëdhënie Etnike, retorika e Vuçiqit është e rrezikshme, krijon atmosferë të keqe dhe mund të ndikojë edhe në pozitën e serbëve në veri të Kosovës. “Ai tani po e përdor këtë për ta zgjatur disi pushtetin apo për të fituar diçka në zgjedhje, por rreziku është i madh. Ta përdorësh këtë si një mantrë ideologjike-propagandistike është e rrezikshme”, ka vlerësuar Janjiq.

Deklaratat e Vuçiqit për ndryshimin e rrjedhës së Ibrit kanë ardhur në një kohë kur ai po përballet me kritika nga një pjesë e opinionit publik në Serbi, sipas të cilave nuk ka bërë mjaftueshëm për ta mbrojtur pronën e serbëve në veri të Kosovës.

Autoritetet e Kosovës kanë nisur më 21 korrik rrënimin e shtëpive të ndërtuara pa leje pranë Liqenit të Ujmanit në veri të vendit, zonë e banuar me shumicë serbe.

Autoritetet në Prishtinë i kanë konsideruar deklaratat e Vuçiqit si shantazh politik dhe kërcënim, gjë që Beogradi zyrtar e ka mohuar.

Lumi Ibër, rreth 270 kilometra i

gjatë, buron në Mal të Zi, kalon nëpër Serbi, hyn në Kosovë, ku rrjedh për rreth 82 kilometra, dhe më pas rikthehet në Serbi. Ai furnizon me ujë liqenin artificial të Ujmanit, i cili shtrihet në zonën kufitare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Rreth dy të tretat e liqenit ndodhen në territorin e Kosovës.

Realitet apo demagogji politike?

Profesori i hidraulikës dhe burimeve ujore në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT) në Kosovë, Alban Kuriqi, ka thënë se mundësia e ndërprerjes së prurjeve të ujit në Ujman duhet parë para së gjithash si një vendim politik. Ai ka shpjeguar se një projekt i tillë do të ishte jashtëzakonisht i ndërlikuar teknikisht dhe shumë i kushtueshëm. “Megjithatë, nga një perspektivë afatgjatë inxhinierike, devijimi i pjesshëm ose marrja e një sasive të konsiderueshme uji në rrjedhën e sipërme është teknikisht e mundshme dhe për këtë arsye nuk duhet të hidhet poshtë plotësisht si e pamundur”, ka thënë Kuriqi.

Por, sipas tij, kjo do të kërkonte infrastrukturë të madhe hidroteknike. Do të duhej të ndërtohej një digë për devijimin e ujit, objekte për marrjen e ujit dhe një kanal, tubacion ose tunel i madh për ta transportuar atë drejt një pellgu tjetër ujëmbledhës apo një rezervuari tjetër. “Nëse transportimi me gravitet nuk do të ishte i mundur, do të nevojitej edhe infrastrukturë e konsiderueshme pompimi, si dhe energji për funksionimin e saj. Një projekt i tillë do të kërkonte gjithashtu studime të hollësishme topografike, gjeologjike, hidrologjike dhe mjedisore, mjete të konsiderueshme financiare dhe shumë kohë për ndërtim”, ka thënë Kuriqi.

Cilat do të ishin pasojat?

Uji nga Liqeni i Ujmanit furnizon sistemin Ibër-Lepenc, i cili siguron ujë për objekte industriale dhe mundëson ujitjen e tokave bujqësore. Prej tij furnizohen me ujë disa qytete të Kosovës. Uji përdoret gjithashtu nga hidrocentralet i Ujmanit, ndërsa Korporata Energjetike e Kosovës e shfrytëzon atë për ftohjen e termocentraleve. “Ujmani varet në masë të madhe nga këto prurje nga rrjedha e sipërme. Vlerësimet e Bankës Botërore tregojnë se pothuajse i gjithë uji që Ibri sjell në Ujman vjen nga Mali i Zi dhe Serbia. Prurja mesatare afatgjatë në rezervuar vlerësohet në rreth 11 metra kub për sekondë, megjithëse ajo ndryshon ndjeshëm mes viteve me reshje dhe atyre të thata, si dhe sipas stinëve”, ka thënë Kuriqi. Ai ka shpjeguar se rezervuari i Ujmanit ka kapacitet



të konsiderueshëm për ruajtjen e ujit, prandaj zvogëlimi i prurjeve nuk do të nënkuptonte që Kosova do të mbetej menjëherë pa furnizim me ujë. Megjithatë, ai ka paralamjëruar se një zvogëlim i madh dhe afatgjatë i prurjeve do të kishte pasoja serioze për Kosovën. “Kjo do ta zvogëlonte prodhimin e energjisë hidroelektrike dhe, me kalimin e kohës, do të kërkonte vendime gjithnjë e më të vështira për ndarjen e ujit mes furnizimit të popullsisë, prodhimit të energjisë elektrike, industrisë, bujqësisë dhe sigurimit të rrjedhës ekologjike. Pasojat, rrjedhimisht, do të vareshin në masë të madhe nga shkalla dhe kohëzgjatja e zvogëlimit të prurjeve, si dhe nga niveli i ujit në rezervuar në momentin kur do të fillonte një zvogëlim i tillë”, ka thënë ai.

Një nga instrumentet kryesore globale që rregullon çështjet e ujërave ndërkufitare është Konventa e Kombeve të Bashkuara e vitit 1997 për përdorimin e rrjedhave ujore ndërkombëtare për qëllime të tjera përveç lundrimit. Serbia është palë në këtë konventë. Kosova nuk është, pasi nuk është anëtare e Kombeve të Bashkuara. Konventa, ndër të tjera, përcakton parimin e përdorimit të drejtë dhe të arsyeshëm të ujërave ndërkufitare dhe detyrimin për të mos u shkaktuar dëme të konsiderueshme shteteve të tjera.

Përplasja e ministrave në rrjetet sociale

Ideja për ndryshimin e rrjedhës së Ibrit ka nxitur një përplasje në rrjetin social X mes ministrave të Jashtëm të Shqipërisë dhe Serbisë. Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme i Shqipërisë, Ferit Hoxha, ka thënë se uji nuk mund të përdoret si instrument i presionit politik apo si mjet për ndëshkimin e një vendi apo popullsie tjetër. Ai ka theksuar se “Shqipëria mbështet fuqishëm të drejtën e Kosovës për siguri, zhvillim të qëndrueshëm dhe mbrojtjen e burimeve të saj ujore”.

Ndaj kësaj deklarate ka reaguar shefi i diplomacisë serbe, Marko Gjuriq, duke thënë se Serbia do të vendosë vetë se si do t'i

menaxhojë burimet e saj natyrore. “Vendimi i Tiranës për t'u përfshirë në këtë çështje, duke shpërfillur presionin sistematik ndaj popullsisë serbe dhe sulmet ndaj pronës serbe, ngre në mënyrë të pashmangshme pikëpyetje për motivet politike që qëndrojnë prapa ndërhyrjes së saj”, ka shkruar Gjuriq. Për këtë çështje ka reaguar edhe kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, i cili qëndrimet e Beogradit i ka përshkruar si “folklor politik”. “Lumi Ibër, krejtësisht i pavetëdijshëm për të gjitha hartografitë tona historike, do të vazhdojë të rrjedhë sipas gjeografisë dhe jo sipas folklorit”, ka thënë Rama.

Kërcënim dhe presion politik?

Për autoritetet e Kosovës, ideja e ndryshimit të rrjedhës së Ibrit është “absurde”, “kërcënuese” dhe “shoviniste”. (Hidrosistemi) Ibër-Lepenc dhe Liqeni i Ujmanit janë pjesë e një sistemi jetik për furnizimin me ujë, energjinë, bujqësinë dhe jetën e qindra mijëra qytetarëve të Kosovës”, ka paralamjëruar ushtruesja e detyrës së presidentes së Kosovës, Albulena Haxhiu.

Më herët, ministrja në detyrë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fitore Pacolli, e kishte cilësuar “shqetësuese” deklaratën e Vuçiqit për ndryshimin e rrjedhës së Ibrit. “Resurset ujore nuk mund të përdoren si instrument kërcërimi, presioni apo destabilizimi ndaj një shteti tjetër”, ka thënë Pacolli.

Vuçiq, në anën tjetër, ka thënë se me ngritjen e kësaj ideje nuk po kërcënon askënd, por vetëm po “merret me rrjedhat ujore në territorin e Republikës së Serbisë”. “Meqë po e keqtrajtojnë kaq shumë popullin tonë, të shohim – kemi arsye të ndryshme për ndryshimin e rrjedhës së Ibrit, e pastaj do të shohim çfarë do të bëjnë shqiptarët dhe si do të sillen”, ka thënë ai.

Dushan Janjiq ka kujtuar se një veprim i tillë nuk do të kishte pasoja vetëm për shqiptarët. “Si t'ia shpjegojmë tani atij (Vuçiqit) se në veri të Kosovës jetojnë edhe serbë?”, ka thënë me ironi Janjiq.

Liqeni i Ujmanit ndodhet kryesisht në komunën e Zubin Potokut, në veri të Kosovës, të banuar me shumicë serbe, ndërsa një pjesë më e vogël e tij shtrihet në komunën e Tutinit në Serbi.

Ideja është përmendur edhe më herët

Ideja për ndryshimin e rrjedhës së Ibrit nuk është e re. Në dhjetor të vitit 2024, pas shpërthimit që dëmtoi kanalin Ibër-Lepenc në Zubin Potok, Vuçiq ka thënë se që nga viti 1985 ekziston një ide për ndryshimin e rrjedhës së lumit për nevojat e popullsisë në Serbi. Ai kishte thënë atëherë se ishte kundër një ideje të tillë, duke theksuar se nuk dëshironte që “natyra të përdorej për qëllime politike”.

Dushan Janjiq ka thënë se edhe në mesin e viteve '80 të shekullit të kaluar, Akademia Serbe e Shkencave dhe Arteve kishte shqyrtuar mundësinë e ndryshimit të rrjedhës së Ibrit, por se në fund ishte hequr dorë nga kjo ide. “Pra, kjo në vetvete nuk është diçka e re. Ekzistojnë projekte të tilla dhe ato hyjnë në atë që quhet gjeopolitikë. Sidomos te këto lloje ideologjish nacionaliste, ku ke një udhëheqës që mendon se mund ta ndryshojë gjithë botën. Kjo është ëndrra e tij (e Vuçiqit) se kur ke pushtet, mund ta ndryshosh edhe rrjedhën e lumit, edhe lëvizjen e tokës”, ka shtuar ai.

Çfarë ndodhi me “modelin e Kolumbias” për Ujmanin?

Kosova dhe Serbia më 4 shtator 2020 kanë nënshkruar Marrëveshjen e Uashingtonit për normalizimin ekonomik të marrëdhënieve mes tyre, në praninë e presidentit amerikan Donald Trump. Një nga pikat e marrëveshjes ka të bëjë edhe me Liqenin e Ujmanit. Në vitin 2021, Shtetet e Bashkuara i kanë dorëzuar Kosovës dhe Serbisë një studim fizibiliteti për menaxhimin e përbashkët të Liqenit të Ujmanit, sipas modelit të marrëveshjes për digat në lumin Kolumbia në veriperëndim të Paqësorit. Marrëveshja për lumin Kolumbia është arritur në vitin 1961 dhe, në bazë të saj, janë ndërtuar katër diga: tri në Kanada dhe një në shtetin amerikan të Montanës. Studimi ka propozuar, ndër të tjera, edhe krijimin e një komisioni për lumin Ibër, i cili do ta lehtësonte diskutimin ndërmjet palëve për mundësitë e menaxhimit të burimeve ujore. Megjithatë, propozimi nuk është zbatuar deri më sot. Departamenti Amerikan i Shtetit nuk i është përgjigjur deri në publikimin e këtij artikulli pyetjeve të “Radios Evropa e Lirë” se çfarë ka ndodhur me këtë plan dhe nëse ai vazhdon të jetë aktual.

Ankandi i gjashtë i letrave me vlerë për vitin 2026 pritet të mbahet më 19 gusht

PRISHTINË, 12 GUSHT - Ministria e Financave ka njoftuar se më 19 gusht 2026 do të mbahet ankandi i gjashtë i letrave me vlerë për vitin 2026. Në këtë ankand do të emetohen obligacione me maturitet

shtatëvjeçar në shumën prej 15 milionë eurosh.

Sipas një njoftimi për medie, investimi në obligacione është investim i sigurt, i garantuar me Ligjin për Borxhin Shtetëror dhe

Garancitë Shtetërore, ku interesi i përcaktuar nga tregu u garantohet investitorëve për të gjithë kohëzgjatjen, prej shtatë vitesh, dhe është tërësisht i liruar nga tatimi. “Për detaje rreth pjesëmarrjes

në ankande për blerjen e letrave me vlerë, ju lutem kontaktoni ndonjërin nga bankat komerciale që operojnë në Republikën e Kosovës”, është thënë në njoftim.



INFLACIONI NË KOSOVË ARRIN NË 6.5 PËR QIND

PRISHTINË, 12 GUSHT - Inflacioni vjetor në Kosovë ka arritur në 6.5 për qind në muajin korrik 2026, ndërsa krahasuar me qershorin, çmimet e konsumit janë rritur për 0.6 për qind. Këto të dhëna janë publikuar nga Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) për Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK). Sipas ASK-së, rritja më e madhe vjetore e çmimeve është regjistruar te transporti, me 17.8 për qind, pasuar nga strehimi, uji, energjia elektrike, gazi dhe lëndët e tjera djegëse, me 11.1 për qind.

Rritje prej 5.3-përqindësh është shënuar te pijet alkoolike, duhani dhe narkotikët, si dhe te restorantet dhe shërbimet e akomodimit. Çmimet në shëndetësi janë rritur për 4 për qind, ndërsa kujdesi per-



sonal, mbrojtja sociale dhe mallrat e shërbimet e ndryshme janë shtrenjtuar për 3.7 për qind.

Veshjet dhe këpucët kanë

shënuar rritje prej 2.8-përqindësh, ushqimet dhe pijet joalkoolike 2.7 për qind, mobiliet, pajisjet shtëpiake dhe mirëmbajtja rutinore e

shtëpisë 2.5 për qind, ndërsa rekreacioni, sporti dhe kultura 2.3 për qind.

Në anën tjetër, krahasuar me korrikun e vitit të kaluar, rënie e çmimeve është regjistruar te shërbimet arsimore, për 0.5 për qind, dhe tek informacioni dhe komunikimi, për 0.1 për qind. Në nivel mujor, IHÇK-ja është rritur për 0.6 për qind në korrik, krahasuar me qershorin 2026. Edhe në këtë krahasim, transporti ka pasur ndikimin kryesor, me rritje të çmimeve prej 4.3 për qind. Rekreacioni, sporti dhe kultura janë shtrenjtuar për 1.9 për qind, ndërsa restorantet dhe shërbimet e akomodimit për 1 për qind.

Rritje më e vogël është evidencuar te kujdesi personal, mbrojtja sociale dhe mallrat e shërbimet e ndryshme, me 0.4 për qind, veshjet dhe këpucët, me

0.3 për qind, si dhe pijet alkoolike, duhani dhe narkotikët dhe shërbimet arsimore, me nga 0.1 për qind. Ndërkaq, ushqimet dhe pijet joalkoolike janë liruar për 1 për qind krahasuar me qershorin. Rënie prej 0.6-përqindësh është shënuar te mobiliet, pajisjet shtëpiake dhe mirëmbajtja rutinore e shtëpisë, ndërsa te shëndetësia dhe informacioni e komunikimi çmimet kanë rënë për nga 0.1 për qind.

Çmimet e konsumit janë rritur për 6 për qind në qershor të këtij viti krahasuar me qershorin e vitit të kaluar. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, Indeksi i tërësishëm i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit ishte më i lartë mesatarisht për 6 për qind në muajin qershor 2026 krahasuar me muajin qershor 2025.

RAFUNA: EKSPORTET JANË RRRITUR ME MBI 1 MILIARD, INSTITUCIONET TË KENË KUJDES SI PO I TRAJTOJNË PRODUKTET VENDORE

PRISHTINË, 12 GUSHT - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (EOK), Lulzim Rafuna, ka shprehur shqetësim për mënyrën se si institucionet shtetërore po i trajtojnë produktet vendore, duke iu referuar veçanërisht Ministrisë së Bujqësisë dhe Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës. Rafuna ka thënë se trajtimi i produkteve vendore nuk është i drejtë dhe se çdo veprim institucional që krijon dyshime apo panik te konsumatorët mund të dëmtojë një zinxhir të tërë ekonomik, nga fermerët dhe përpunuesit deri te prodhuesit dhe konsumatorët. “Ne gjithmonë kemi kërkuar që prodhimet kosovare të mbështeten për shkak se edhe ashtu kemi pak prodhime që i prodhojmë në Kosovë dhe na ka mbyjtë importi. Dhe në qoftë se i shohim të dhënat zyrtare, shohim që... në qoftë se i kraha-

sojmë me vitet e mëparshme, për shembull prej vitit 2022, shohim që mbi 1 miliard është rritur importi, ndërsa eksporti ka mbetur në vlera të njëjta”, ka thënë Rafuna. Ai ka theksuar se deficitit tregtar, sipas të dhënave që paraqiti, është tkurrur nga 18.6 për qind në vitin 2022 në 14.4 për qind.

Kreu i OEK-ut ka kërkuar nga institucionet të tregojnë kujdes me deklaratimet dhe veprimet e tyre në mënyrë që të mos dëmtohet imazhi i produkteve vendore. “Kërkojmë me urgjencë nga institucionet e vendit, në këtë rast nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës, por edhe nga Ministria e Bujqësisë, që të mos marrin veprime të cilat e prishin imazhin ose krijojnë të pavërtetë, ose edhe panik te konsumatorët që të mos i blejnë produktet e Kosovës”, ka thënë ai.



Rafuna ka vlerësuar se produktet e Kosovës prodhohen sipas standardeve të larta dhe se mund të konkurrojnë me produktet e tregjeve rajonale dhe evropiane. “Produktet e Kosovës prodhohen me standardet më të larta, janë me cilësinë më të lartë”, ka thënë ai, duke shtuar se prodhuesit vendorë janë në gjendje t’u bëjnë konkurrencë edhe kompanive me përvojë shumëvjeçare në tregjet ndërkombëtare.

Sipas tij, prodhimet vendore nuk e meritojnë një trajtim që mund ta dëmtojë besimin e

konsumatorëve. “Kërkojmë që produktet tona të subvencionohen, të mbrohen, por edhe të punohet që t’u gjendet një treg më i madh”, ka thënë Rafuna.

Ai ka theksuar rëndësinë e kompanive vendore për ekonominë e Kosovës, duke thënë se ato kanë krijuar mijëra vende pune. Rafuna i ka ofruar bashkëpunim Ministrisë së Bujqësisë dhe AUV-it për adresimin e çështjeve që lidhen me kontrollin dhe promovimin e produkteve vendore. “Këto kanë krijuar me mijëra vende pune dhe janë një segment shumë i rëndësishëm i degës së zhvillimit ekonomik dhe Oda Ekonomike e Kosovës është e gatshme që në çdo kohë, 24/7, t’i ofrojë Ministrisë, por edhe AUV-it, të gjithë asistencën, mbështetjen, por edhe dialogun, që ta zgjidhim këtë paraqitje të produkteve tona që është krijuar me këto konferen-

cat e fundit”, ka thënë ai.

Kreu i OEK-ut ka paralajmëruar se dëmtimi i imazhit të produkteve vendore mund të ketë pasoja të drejtpërdrejta për mijëra fermerë dhe punëtorë. “Janë produkte të Kosovës, janë mijëra vende të punës që mund të humbin, janë mijëra fermerë që mund t’i humbin bagëtitë e tyre si rezultat i krijimit të një imazhi jo të mirë për prodhimet tona”, ka thënë Rafuna.

Ai ka theksuar se kompanitë vendore kanë kapacitete për të eksportuar në tregun e Bashkimit Evropian, por ka kërkuar nga institucionet të punojnë më shumë për krijimin e kushteve të nevojshme për këtë. Sipas Rafunës, një prej pengesave lidhet me njohjen e certifikatave veterinarë. “Në vend që ne të punojmë që produktet tona të dalin, ne po e bëjmë të kundërtën”, ka thënë ai.

KEK-u ndalon njësinë “A4” pas parregullsive teknike

PRISHTINË, 12 GUSHT - Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) ka njoftuar se Njësia “A4” është ndaluar në mënyrë të kontrolluar pas evidentimit të disa parregullsive teknike. Sipas njoftimit të KEK-ut, ndalja është bërë më 11 gusht 2026, në orën 00:00, si masë

parandaluese dhe në përputhje me kërkesat e sigurisë teknike. Qëllimi i ndaljes, sipas KEK-ut, është krijimi i kushteve të nevojshme për kontrollin e pajisjeve dhe kryerjen e ndërhyrjeve përkatëse.

“Ekipe profesionale janë angazhuar menjëherë në

vlerësimin e gjendjes teknike, identifikimin e shkakut dhe ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për eliminimin e problemit”, është thënë në njoftim.

KEK-u ka bërë me dije se Njësia “A4” do të rikthehet në operim pas përfundimit të

kontrolleve dhe ndërhyrjeve teknike, si dhe pasi të konfirmohen kushtet e sigurta për funksionim. Korporata ka njoftuar se për zhvillimet e mëtejshme dhe kohën e rikthimit të njësive në operim do ta informojë publikun me kohë.



NJË RADIKAL POLAK DHE NJË NAZIST NË NJË QELI PËR 255 DITË

Nga: Frances WILSON
(*The Telegraph*)

Në vitin 1945, Kazimierz Moczarski, ish-oficer i Rezistencës Polake, u kap nga policia sekrete e Stalinit dhe u dënua, si armik i shtetit, me 11 vjet në burgun Mokotuv të Varshavës. Atje iu nënshtrua 49 llojeve të ndryshme të torturës, njëra prej të cilave ishte ndarja e një qelie - nga 2 marsi deri më 11 nëntor 1949 - me dy nazistë. Burri më i moshuar, i cili mbante pantallona burgu dhe nallane dhe të cilin i mungonin disa dhëmbë, ishte Gustav Schielke, një punonjës i rangut të ulët në arkivin e policisë së sigurisë. Më i riu, i cili mbante një xhakë të kuqe të errët, një shami të lidhur rreth qafës dhe çizme lëkure të lustruara deri në shkëlqim, ishte komandanti i njësisë SS, Jürgen Stroop - një nga arkitektët e Holokaustit dhe likuiduesi i Getos së Varshavës i cili tani priste ekzekutimin.

Pasi dikur kishte provuar ta vriste Stroopin, Moczarski ishte i përcaktuar ta shfrytëzonte këtë mundësi për të nxjerrë prej tij sa më shumë informacione. "Nëse jam me kriminelë luftë", shkroi më vonë në Biseda me një xhelat [Conversations with an Executioner] - rrëfimin e tij për këto 255 ditë - "atëherë duhet t'i njoh, të përpiqem të zbërthej fjetet e historive të jetës dhe personaliteteve të tyre". Synimi i Moczarskit ishte të zbulonte "se cili mekanizëm historik, psikologjik, sociologjik bëri që disa gjermanë të bashkoheshin në një bandë vrasësish masive që sunduan Rajhun".

Rezultati është një rrëfim mahnitës për narcizmin e nazizmit. Stroopi, të cilit asgjë nuk i pëlqente më shumë sesa tingulli i zërit të vet, doli të ishte burim i shkëlqyer për hulumtim dhe ato që Moczarski i quan "biseda" - të rrëfyera këtu kryesisht të plota - ishin më shumë monologë mburraveçë. I papendur deri në fund, Stroopi fliste me entuziazëm të zjarrtë për dashurinë e tij ndaj pyjeve gjermane, gjinjtë e grave malësore "të pista dhe të egra" karpato-rumune, si dhe pronat në Ukrainë që do të kishte zotëruar po ta kishte fituar luftën: "Një shërbëtor do ta shtronte tryezën për darkë ... Gjëmimi i largët i motorëve sovjetikë që pomponin ujë në arat me shalqinj". Hannah Arendt krijoi shprehjen "banaliteti i së keqes" për të përshkruar "fenomenin që shikonte drejt në sy" në gjyqin e Adolf Eichmannit në vitin 1961. Moczarski e kap këtë anë qesharake të Stroopi, i cili mbante monokël ndonëse shikimin e kishte të përsosur. Duke i krahasuar privimet e tij në burg me privilegjet që lejoheshin në Dahau, ku "çdokujt i garantohej një furçë dhëmbësh, sapun, letër higjienike ...", ai

nganjëherë ia jepte këngës; në rastet e tjera demonstronte se si kalërohej, duke u lëkundur para e prapa me këmbë të përkulura, "fillimisht në hap, pastaj në trok dhe në fund në galop. Bërtiste, lëshonte tinguj, fshikullonte një kalë imagjinar dhe turfullonte e hingëllinte si kalë".

Meqë në burg nuk i lejohej të mbante fletore, Moczarski fillimisht e hartoi në mendje librin Rrëfimet e një xhelati, duke përfytyruar secilën faqe tekta "shkruante" mbi të dhe duke shënuar mendërisht pjesët që duheshin rishikuar. "E pash veten në një gjendje përqendrimi të jashtëzakonshëm - do të thosha madje fenomenal", shpjegoi ai. Moczarski e quante librin që doli prej kësaj një "raport" ("zbukurimet letrare më duken të papërshtatshme"), por Biseda me një xhelat është më elegant dhe më i stilizuar se kaq. I përbërë kryesisht prej dialogëve, lexohet si një dramë; por, po aq mirë, mund të shërbente edhe si biografi e Stroopit.

"Biografi ideal duhet të ketë ngrënë bukë me subjektin e tij", ka thënë Dr. Samuel Johnsoni, dhe Moczarski hëngri më shumë se 600 vakte bashkë me shokun e tij të qelisë - megjithëse "bashkë" nuk është fjala e duhur, sepse



Kazimierz Moczarski, ish-oficer i Rezistencës Polake, rreth vitit 1956

Stroopit, në shenjë njohjeje të statusit të tij, i lejoheshin racione të dyfishta ushqimi. Ai hante ngadalë, vëren Moczarski, dhe pastaj i lironte pantallonat, "duke i mbërthyer në njërin prej kopsave shtesë në bel që kishte qepur për një bark të ngopur 'mesatar' ose 'të madh'". Ja ku, me një të rënë të lapsit, e kemi njeriun: [biografi] Boswelli nuk do të mund ta kishte bërë më mirë. Tipari përcaktues i karakterit të Stroopit ishte respekti i tij për hierarkinë. Kjo përfshinte



edhe rendin hierarkik brenda qelisë: Moczarski, këmbëngulte ai, duhej ta kishte shtratin e vetëm, sepse "ti je pjesëtar i kombit sundues këtu, kombit fitimtar, pra i racës së zotërinjve". Kredoja e tij ishte "besnikëri, besnikëri, besnikëri", ndërsa kuptimi i thjeshtëzuar i botës që kishte përvetësuar në shkollën fillore ishte rafinuar nga propaganda: "francezët janë maskarenj dhe pa qytetari ... Anarkistë dhe snobë ... Gratë franceze janë përgjithësisht kurva".

të madhe të armatosur të hebrenjve kundër nazistëve gjatë luftës. I tronditur që këta hebrenj, si nënjerëz, ishin luftëtarë kaq të egër, Stroopi urdhëroi djegien e getos, rrugë më rrugë, shtëpi më shtëpi.

Duke kujtuar se si familjet që hidheshin nga dritaret e shtëpive të tyre në flakë qëllorshin nga pjesëtarët e SS-it, Stroopi imitonte marrjen në shenjë me një çiftë të rosave në fluturim; pas një dite vrasësh dhe deportimesh, tha ai, kthehej në shtëpi për një "darkë të këndshme". E vetmja herë kur Moczarski u detyrua ta ndërpriste "rapsodinë sublimë" të Stroopit ishte kur ky përshkroi një nënë gjysmë të vetëdijshme që tërhoqej zvarrë nga rrënojat e shtëpisë ku foshnja e saj kishte mbetur pas. "Mjaft, hesht", urdhëroi Moczarski. "Atë ditë nuk folëm më".

Vetëm pasi u fal dhe u lirua në vitin 1956, Moczarski mundi ta çlironte mendjen nga barra dhe t'i hidhte dialogët në letër. Por, vërtetësia e materialit të tij shumë shpejt u vu në dyshim. Burgimi, argumentonte Moczarski, i kishte

mundësuar ta stërviste kujtesën në një shkallë të jashtëzakonshme.


Edhe aftësia e Stroopit për të kujtuar ishte po aq mbinjerëzore. "Raporti im për likuidimin e Getos së Varshavës sikur është shtypur brenda mendjes sime", i tha ai Moczarskit. "Thjesht mund ta shoh, faqe për faqe". Kur Moczarski kontrollloi faktet që i kishte treguar Stroopi duke i krahasuar me provat në dosjet e tij të luftës, zbuloi se pothuajse nuk kishte gabime.

Asnjë botues në Poloninë komuniste nuk pranonte ta prekte librin Biseda me një xhelat, e cila përfundimisht u botua me vazhdime në revistën mujore Odra midis viteve 1972 dhe 1974. Dy vjet pasi Moczarski vdiq në vitin 1975, në moshën 68-vjeçare, libri i tij doli në një botim të censuruar; versioni i plotë dhe i pacensuruar nuk do të botohej deri në vitin 1992, kur u bë bestseller. Tani, i përkthyer shkëlqyeshëm nga Sean Gasper Bye, ky botim i fundit e konfirmon "raportin" e Moczarskit si një kryevepër të letërsisë së shekullit XX.

/Telegrafi



Stroopi i fotografuar gjatë burgimit të tij në Dahau



QENDRA SPORTIVE

'BUJQËSIA'

TEL: 045/82 82 82

Vazhdon beteja për Rodrin, Barcelonën dhe Manchester Cityn i ndajnë 20 milionë euro

BARCELONË, 12 GUSHT - Barcelona po përshpejton për transferimin e Rodrit dhe i ka paraqitur Manchester Cityt një ofertë të re verbale. Sipas ekspertit të transfereve Fabrizio Romano, klubi katalanas ka ofruar 60 milionë euro në total,

përfshirë bonuset. Në anën tjetër, Manchester City vazhdon të kërkojë rreth 80 milionë euro për të lejuar largimin e mesfushorit spanjoll. Megjithatë, në Barcelonë mbizotëron optimizmi se marrëveshja mund të arrihet,

me strukturën e bonuseve që pritet të jetë çelësi për ta mbuluar diferencën prej 20 milionë eurosh. Rodri është një nga mesfushorët më të vlerësuar në botë dhe ka qenë ndër lojtarët kryesorë të sukseseve të Spanjës në turnetë

e fundit. Ai është shpallur lojtari më i mirë i turneve pas triumfeve të Spanjës dhe, me sukseset e arritura, ka hyrë në një rreth të ngushtë futbollistësh që kanë fituar trofetë më të rëndësishëm në karrierë.



FILLON PUNËN AKADEMIA E PORTIERËVE PËR GJENERATAT 2011 DHE 2012

PRISHTINË, 12 GUSHT - Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) ka nisur një tjetër projekt të rëndësishëm në kuadër të zhvillimit të futbollit të grupmoshave të reja, me fokus të veçantë në identifikimin dhe zhvillimin e portierëve të talentuar.

Në kuadër të këtij projekti ka nisur puna në Kampin Nacional të FFK-së në Hajvali, i dedikuar portierëve të gjeneratave 2011 dhe 2012 për djem dhe për vajza.

Qëllimi i këtij programi është identifikimi i hershëm i talentëve në këtë pozitë dhe krijimi i një procesi të vazhdueshëm të punës me ta, me synim zhvillimin e tyre



profesional dhe përgatitjen për të ardhmen e ekipeve zinxhir të Kombëtares së Kosovës. Faza e parë e programit do t'i kushtohet seleksionimit të portierëve nga të gjitha

regjionet e Kosovës. Seleksionimi ka filluar dhe do të zhvillohet gjatë katër ditëve, e ku janë të përfshirë rreth 100 portierë e portiere nga 7 regjionet e Kosovës.

Pas përfundimit të procesit të seleksionimit, portierët e përzgjedhur do të vazhdojnë të jenë pjesë e programit të Akademisë, ku do të punohet në mënyrë të strukturuar dhe të vazhdueshme për zhvillimin e tyre. Programi do të zhvillohet në dy sesione. Sesioni i parë do të zhvillohet nga shtatori deri në nëntor, ndërsa pas pauzës dimërore puna do të vazhdojë me sesionin e dytë, nga shkurti deri në maj. Në këtë mënyrë FFK synon që portierëve të rinj t'u ofrojë një proces të qëndrueshëm zhvillimi përmes punës së specializuar dhe monitorimit të vazhdueshëm, duke krijuar një

bazë sa më të gjerë të talentëve për ekipet e ardhshme kombëtare.

Projekti i Akademisë së Portierëve zhvillohet në kuadër të Departamentit të Edukimit të FFK-së, ndërsa mbikëqyrët nga Samir Ujkani, anëtar i Komitetit Ekzekutiv të FFK-së. Në realizimin e këtij programi janë të angazhuar trajnerët Valmir Bytyqi, Flamur Neziri, Artan Sadriu dhe Diellza Musa. Përmes këtij projekti, FFK vazhdon investimin në zhvillimin e gjeneratave të reja dhe në krijimin e një sistemi të qëndrueshëm për identifikimin dhe avancimin e talentëve, me theks të veçantë në pozitën e portierit.

FIFA NIS PUNËN ME 19 VAJZA TË TALENTUARA NË KOSOVË

PRISHTINË, 12 GUSHT - Akademia e FIFA-s në kuadër të Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK) ka nisur punën intensive me talentet e reja të futbollit, me fokus të gjeneratave 2012 dhe 2013. Në program janë përfshirë 19 vajza të talentuara, të përzgjedhura nga të gjitha Lidhjet Rajonale të Futbollit në Kosovë. Ato janë identifikuar gjatë procesit të vëzhgimit të talentëve, i cili është zhvilluar në të gjitha rajonet e vendit gjatë muajit qershor. Programi zhvillohet në kuadër të FIFA Talent Development Scheme, me synim që talentet e reja të kenë mundësi të barabarta për zhvillim dhe të përgatiten për nivelet më të larta të futbollit. Nën mbikëqyrjen e ekspertit të FIFA-s, Rainer Kraft, futbollistet do të ndjekin një program të strukturuar dhe stërvitje



të specializuara, me fokus në zhvillimin e mëtejshëm të aspekteve teknike, taktike dhe fizike. Akademia e FIFA-s në Kosovë, e cila është e para e këtij lloji në shtetet e Ballkanit, synon që përmes këtij programi të krijojë një bazë të fortë për zhvillimin e gjeneratave të reja dhe të kontribuojë në përgatitjen e futbollisteve që në të ardhmen mund të bëhen pjesë e ekipeve kombëtare të Kosovës.

BARCELONA, BORUSSIA DORTMUNDI DHE TOTTENHAMI INTERESOHEN PËR ASLLANIN

HOFFENHEIM, 12 GUSHT - Fisnik Asllani ishte marrë vesh për çdo detaj me Leipzigun, por transferimi ka dështuar pas problemeve të evidentuara gjatë kontrolleve mjekësore. Marrëveshja parashikonte një investim prej 25 milionë eurosh, që mund të arrinte deri në 30 milionë me bonuse si dhe një kontratë deri në vitin 2031. Pas anulimit të transferimit, Hoffenheimi ka dalë në krah të sulmuesit kosovar dhe nuk pritet ta largojë për një shumë më të ulët se 25 milionë euro.

Për shërbimet e Asllanit janë të interesuara Barcelona, Borussia Dortmundi dhe



Tottenhami, të cilat e kanë monitoruar futbollistin gjatë afatit kalimtar.

Barcelona po kërkon një sulmues qendër, ndërsa lidhja mes klubit katalanas dhe Asllanit nuk është e re, pasi futbollisti ka shprehur publikisht admirimin për Barcelonën. Edhe Dortmundi dhe Tottenhami vazhdojnë ta monitorojnë situatën dhe mund të bëjnë lëvizje konkrete pas dështimit të marrëveshjes me Leipzigun. Asllani sezonin e kaluar e përfundoi me 11 gola dhe 8 asistime në 35 ndeshje, ndërsa sipas "Transfermarkt" vlera e tij është 35 milionë euro dhe kontrata me Hoffenheimin i skadon në vitin 2029.

Leo Messi mund të shkëputet nga futboli?

MIAMI, 12 GUSHT - Lionel Messi është goditur rëndë nga vdekja e babait të tij, Jorge Messi dhe, sipas raportimeve nga mediet argjentinase, po shqyrton mundësinë e një shkëputjeje nga futboli aktiv. Pas humbjes së babait, Messi raportohet se

ka vendosur të qëndrojë në Argjentinë pranë familjes dhe të pezullojë përkohësisht angazhimet e tij.

Mësohet se ai ka njoftuar edhe Inter Miamin për vendimin, por pa përcaktuar një datë për rikthimin te skuadra

amerikane. Kjo situatë ka nxitur spekulime në Argjentinë për mundësinë që Messi të marrë edhe një vendim më të madh dhe të tërhiqet nga futboli. Megjithatë, deri tani nuk ka asnjë konfirmim zyrtar për një tërheqje të mundshme

nga futboli aktiv. Jorge Messi ka ndërruar jetë pas një sëmundjeje të gjatë dhe kishte një rol të rëndësishëm në karrierën e djalit të tij, duke shërbyer si agjent dhe këshilltar strategjik i Lionel Messit.





Në mbështetje të nenit 8, nenit 10 nën par. 2.2 dhe nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.12.2010, lidhur me nenin 7 të Udhëzimit Administrativ MFPT - Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik i cili është pjesë e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i cili është i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 31.10.2017, dhe nenit 18 dhe nenin 22 të Rregullores Nr. 13/25 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të miratuar nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L. "Përparimi" Sh. A e duke u bazuar në vendimin me nr. të protokollit 1801/26 të datës 11.08.2026 të Kryeshefit Ekzekutiv, N.P.L. "Përparimi" Sh. A, me datë 11.08.2026, shpall:

KONKURS PUBLIK I JASHTËM

- I. Titulli:** Mbikëqyrës i Terrenit të Mirëmbajtjes – Pastrimit të Zyrave dhe Objekteve
Numri i ekzekutuesve: 1
Orët e punës: 40 orë në javë
Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) vit, nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.
Përgatitja profesionale: Përgatitje universitare apo shkollim të mesëm
Përvoja e punës: Preferohet një (1) vit
I raporton: Udhëheqësit të Njësive të Mirëmbajtjes – Pastrimit të Zyrave dhe Objekteve
Lartësia e pagës mujore: 520.00 Euro Bruto

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Të jetë i aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryejë detyrat e punës.
- Siguron që punonjësit e pastrimit të kryejnë detyrat e tyre sipas standardeve të kërkuara të punës.
- Mbikëqyrë cilësinë e shërbimit të mirëmbajtjes të ofruar nga ndërmarrja.
- Koordinon punët ndërmjet ekipeve të mirëmbajtjes.
- Përgatitë raporte për punët që kryhen në kuadër të njësive të pastrimit.
- Kryejnë punë tjera në bazë të urdhrave të menaxhmentit të ndërmarrjes.
- Për punën që kryen i përgjigjet Udhëheqësit të Njësive të Mirëmbajtjes – Pastrimit të Zyrave dhe Objekteve;

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L. "Përparimi" Sh. A - Vushtri.;
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar);
- Ekstraktin e lindjes; (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Certifikatën mbi dënimin penal të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, se nuk ka dënime penale në evidencën qendrore penale të Republikës së Kosovës (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohen);
- Dëshmitë për përvojën e punës (të skanuara) (nuk është obligative);
- Kopjen e letërnjoftimit (e skanuar);

II. Titulli: Shofer i Kamionit

- Numri i ekzekutuesve:** 2
Orët e punës: 40 orë në javë
Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) vit nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.
Përgatitja profesionale: Preferohet Shkolla e mesme
Përvoja e punës: Preferohet gjashtë (6) muaj
I raporton: Menaxherit të Njësive të Mbledhjes dhe Transportimit e Mbeturinave
Koeficienti i pagës: 729.57 Euro Bruto

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Kujdeset për mirëmbajtjen e automjetit transportues, larjen, lyejen, evidentimin e prishjeve etj.
- Drejton dhe mirëmban sipas nevojës edhe automjetet tjera të ndërmarrjes.
- Në fletudhëtim regjistron numrin e kilometrave të kaluara dhe shënimet tjera, të cilat kërkojnë.
- Paraqet çdo defekt dhe dëmtim të shkaktuar në automjet dhe bën arsyetimin e shpenzimeve të derivateve dhe kilometrave të kaluara.
- Me rastin e prishjes së automjetit vozitësi është i obliguar të benë ndreqje të vogla, si ndërrimin e gomës, pastrimin e filterit etj, të qëndrojnë pranë automjetit në punëtori dhe t'i ndihmojë mekanikut ose gomistit.
- Çdo mëngjes është i obliguar të kontrollojë sasinë e vajit, ujit dhe gjendjen e gomave në automjet.
- Është i obliguar që për prishjet në automjet me kohë të lajmëroi kryepunëtorin e vet drejtpërdrejt.
- Kryen edhe punë tjera sipas urdhrave të Menaxhmentit të Ndërmarrjes.
- Për punën e tij i përgjigjet Menaxherit të Njësive të Mbledhjes dhe Transportimit e Mbeturinave.

Kusht i posaçëm:

- Kategoria C e vozitjes.

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L. "Përparimi" Sh. A - Vushtri.;
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar);
- Ekstraktin e lindjes; (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Dëshmia se ka patentën e shoferit të kategorisë C (e skanuar);
- Certifikatën mbi dënimin penal të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, se nuk ka dënime penale në evidencën qendrore penale të Republikës së Kosovës (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohen);
- Dëshmitë për përvojën e punës (të skanuara) (nuk është obligative);
- Kopjen e letërnjoftimit (e skanuar);

III. Titulli: Pastrues i rrugëve

- Numri i ekzekutuesve:** 2
Orët e punës: 40 orë në javë
Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) vit nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.
Përgatitja profesionale: Shkolla fillore
Përvoja e punës: Preferohet një (1) vit
I raporton: Menaxherit të Njësive të Mbledhjes dhe Transportimit të Mbeturinave
Koeficienti i pagës: 623.29 Euro Bruto

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Bën pastrimin e rrugëve të qytetit.
- Bën larjen e rrugëve të qytetit
- Bën pastrimin dhe larjen e trotuareve
- Mirëmban pusetat dhe gypat e ujërave atmosferik;
- Për punën e tij i përgjigjet Menaxherit të njësive të Mbledhjes dhe transportimit

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L. "Përparimi" Sh. A - Vushtri. (E skanuar);
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar);
- Ekstraktin e lindjes; (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Certifikatën mbi dënimin penal të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, se nuk ka dënime penale në evidencën qendrore penale të Republikës së Kosovës (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohen);
- Dëshmitë për përvojën e punës (të skanuara) (nuk është obligative);
- Kopjen e letërnjoftimit (e skanuar);

IV. Titulli: Pastrues i Zyrave dhe Objekteve

- Numri i ekzekutuesve:** 1
Orët e punës: 40 orë në javë
Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) vit nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.
Përgatitja profesionale: Shkolla fillore
Përvoja e punës: Nuk kërkohet përvojë pune
I raporton: Udhëheqësit të Njësive të Mirëmbajtjes - Pastrimit të Zyrave dhe Objekteve
Koeficienti i pagës: 500.00 Euro Bruto

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Do të bëjë pastrimin e zyrave dhe objekteve varësisht nga marrëveshjet që ka punëdhënësi me palët e treta;
- Do të bëjë ruajtjen e mjeteve të punës të cilat përdoren për pastrim;
- Do të pastrojë të gjitha hapësirat për të cilat udhëzohet nga eprori;
- Do të ndjekë rregullat e higjienës dhe rregullat e sigurisë sipas udhëzimeve të eprorit si dhe përgjegjësitë e tjera të cilat ndërlidhen me vendin e punës dhe në bazë të kërkesës së eprorit;
- Kryejnë punë tjera në bazë të urdhrave nga menaxhmenti i ndërmarrjes;
- Për punën që kryen i përgjigjet Udhëheqësit të Njësive të Mirëmbajtjes - Pastrimit të Zyrave dhe Objekteve;

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L. "Përparimi" Sh. A - Vushtri. (E skanuar);
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar);
- Ekstraktin e lindjes; (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
